



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 526 Prot.

Tiranë, më datë 07.04.2023

VENDIM
Nr. 153, datë 06.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin *“Trajtim i fasadës së objektit të shërbimit në Zonën Arkeologjike B, Krujë” Brenda Kufirit Zona Arkeologjike A Krujë*, me aplikues Pirro Karanxha dhe zhvillues Flagron Dedja;
 - Projekti të plotësohet me materiale grafike dhe fotografike për gjendjen ekzistuese të objektit;
 - Në projekt duhet të saktësohen zërat në preventiv sipas manualit;
 - Projekti të plotësohet me specifikimet teknike për objektin;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

